



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

**SHPLLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**“Inspektor” në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Së Tregjeve Prodhuese
Kategoria e pagës III-a**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar si dhe të Kreut VIII, të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- “Inspektor” në Drejtorinë e Mbikëqyrjes Së Tregjeve Prodhuese
- Kategoria e pagës III-a

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

**Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë)
aplikohet në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve:

18 nëntor 2021

****Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.***



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E, B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

Inspektori, kryen inspektime në mënyrë që të siguroj një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të ligjit "Për mbrojtjen e Konkurrencës" duke u mbështetur në tre shtylla kryesore që përcaktojnë mbrojtjen e konkurrencës: abuzimin me pozitën dominuese; marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve dhe bashkimet ose përqendrimet e ndërmarrjeve, si dhe të gjithë kuadrin ligjor që rregullojnë aktivitetin e një institucioni të pavaruar në Republikën e Shqipërisë. Ky institucion e koncepton funksionimin e tij si nxitës dhe avokat i konkurrencës dhe i interesave të konsumatorit, me synimin final që tregu të gjeneroj zhvillimin.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-a),
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit "Master Shkencor", në fushën e ekonomisë,
- b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë,
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë,
- d) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 2 vjet, në nivelin e ulët drejtues,
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E, B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës;
- c) fotokopje të librezës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 18 nëntor 2021

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **19 nëntor 2021** njësi përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësi e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
- c) Konkurrimi do të bazohet dhe në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ” Për Mbrojtjen e Konkurrencës” te ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative
- d) *Për më shumë:* www.caa.gov.al

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E, B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Pranim në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master Shkencor” në fushën e ekonomisë,
- b) Të zotërojë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë,
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë,



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E , B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

- d) Të kenë eksperiencë pune në Administratën Publike jo më pak se 2 vjet,
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
- c) fotokopje të librezës së punës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.
- e) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore
- f) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me poste ose dorazi, *brenda datës 18 nëntor 2021* në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga "Sami Frashëri", kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **19 nëntor 2021**.